



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-30352/24 datë:20.11.2024



Npi – 01/392 datë: 27.11.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.11.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -XI- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 27.11.2024 (e merkurë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtori i DPUKGJ-së z.Grejtalb Emini, Drejtori i DBF-së z.Besnik Ahmeti, Drejtoresha e DSHMS-së znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, Asistentrja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarja për Informim znj.Vlora Hyseni.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.10.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (pas diskutimit publik)
3. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2025-28, (pas diskutimit publik)
4. Propozim-Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale,
5. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.10.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.10.2024.**

Pika 2

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje, Draft-rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 ka shkuar në diskutim publik sipas vendimit të Kuvendit. Diskutimi është mbajtur dhe

kemi disa propozime për ndryshimin e sajë. Te DSHP-ja janë propozuar tarifa të reja të përshkallëzuara për sa u përket kompanive që e shfrytëzojnë gurin si dhe për guroret. Pastaj te DZHE-ja lidhur me pëlqimet që janë lëshuar sipas nenit 7 të rregullores tani kanë kaluar në nivelin qendror, dhe këto hiqen nga rregullorja. Kemi edhe propozime për disa tarifa të reja te DKRS-ja lidhur me shfrytëzimin e hallës sportive. Propozimet e reja për tarifa mund ti shikoni në draftin final të rregullores të cilën e keni pranuar, kështu që nëse ka ndonjë pyetje do të përpiqem të përgjigjem.

z.Kadri Emini: Sa është propozuar çmimi i pagesës për klubet tona që ushtrojnë te halla e sporteve?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Për klubet tona është pa pagesë.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Unë te kjo pike du me abstenuar. Kam një vërejtje te administrata, konkretisht te çertifikatat e vdekjes, unë nuk e shoh të arsyeshme me pas taksë. Kështu që unë do të "abstenoj".

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve të KPF-së present në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025.**

Pika 3

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Mimoza Salihu-Qeriqi.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi drejtoresh e DSHMS: Përshëndetje. Është mbajtur diskutimi publik më 15 Nëntor 2024, sipas vendimit të Kuvendit. Nuk kemi pas propozime konkrete. Procesverbalin për procesin e diskutimit publik e keni pranuar dhe e keni lexuar. Kështu që nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Perparim Ramusa: Unë e përshëndes këtë propozim për Strategjinë për personat me aftësi të kufizuar, kështu që unë jam që të miratohet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve të KPF-së, present në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Strategjis dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28.**

Pika 4

Propozim-Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Ne e kemi obligim ligjor që me miratu fillimisht vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale, konkretisht Ngastrën Kadastrale me numër: P-72809023-00333-16, me sipërfaqe prej: 2894m², në Zonën Kadastrale – Davidovc. Ka të interesuar për me marrë në shfrytëzim këtë pronë por do ta shohim se cila prej tyre i plotëson kushtet ligjore. Kështu që ju ftoj që ta miratoni rekomandimin për Kuvend.

z.Perparim Ramusa: Ne kemi marrë edhe përpara vendime të tilla, dhe ky vendim duhet ti jep dritën jeshile për ta dhënë në shfrytëzim parcelën e caktuar.

z.Lumni Amrushi: Ne me këtë vendim po e japim dritën e gjelbërt për me dhënë nëshfrytëzim këtë përcelë, kështu që ne e mbështesim këtë vendim.

z.Perparim Ramusa: Ne si PDK-ë kurrë nuk jemi kundër për me dhënë prona në shfrytëzim për biznese.

z.Kadri Emini: Tek jo parcelë nuk kemi kurrfar interesi për me ndërtuar diçka. Prandaj ne jemi "pro" për me ua dhënë në shfrytëzim bizneseve. Vërejtja është që jo me lane aty ndonjë pjesë, sepse qysh atëherë kur janë dhënë ato prona aty në shfrytëzim është dashur që të përfshihet edhe kjo pjesë prej 25 ari, e jo me lane vetëm qata 25 ari aty.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve të KPF-së, present në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.**

Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Kemi një kërkesë Nga (KBI) Këshilli i Bashkësis Islame dega në Shtime, ata kanë kërkuar 40 deri në 60 ari sipërfaqe, mirëpo ne mund të ju japim 20 ari për ndërtimin e një Xhamije të re në Shtime. Pjesa tjetër është e Ekonomis Pyjore e që ata duhet të merren vesh me ta. Ne si drejtori e kemi shqyrtuar një mundësi të tillë dhe kemi ardhur në përfundim se qyteti ka nevojë me u zgjeruar në drejtim të Ferizajit dhe ne mundemi me ja propozuar Kuvendit për Miratim dhënjen në shfrytëzim 20 ari sipërfaqe në pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr: P-72809093-03052-3-16, Zona Kadastrale – Shtime, për ndërtimin e Xhamisë së re në Shtime e cila do të jetë në shërbim të komunitetit fetar të besimit Islam. Investitori është i madh dhe investimi sillet mbi një milion euro nga Arabia. KBI-ja i ka filtruar OJQ-të dhe nuk ka mundësi të infiltrimit të ndonjë organizate dashakeqe. Lokacioni gjendet në rrugën “Komandant Kumanova” Ju fttoj që ti rekomandoni Kuvendit për miratim.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. Unë mendoj se ajo pjesë është e pa shfrytëzuar dhe më mire të shfrytëzohet për diçka se sa të mbetet ashtu. Pse mos me shfrytëzu komuniteti fetar.

z.Përparim Ramusa: Sa e di unë 95 % të populates këtu i takojmë komunitetit fetar islam. KBI-dega në Shtime, e ka një kërkesë për lokacion për ndërtimin e një Xhamije, kështu që ne jemi “pro”. Shpresoj që të gjej mirkuptim edhe te Ekonomia Pyjore për pjesën tjetër të oborrit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve të KPF-së, prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:02h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi




Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

